



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 2648/3 Prot.

Durrës, më 18.12.2024

V E N D I M

Nr. 59, Datë 18.12.2024

P Ë R

**"MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E
GRUPEVE MËSIMORE DHE GRUPEVE TË PËRHERSHME OSE TË
PËRKOHSHME KËRKIMORE - SHKENCORE PRANË NJËSIVE BAZË TË
UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës"**

Në mbështetje të ligjit nr.80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij; në ligjin Nr.8480, datë 27.5.1999 "Për funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike"; në Udhëzimin Nr. 27, datë 29.12.2017 për "Strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë"; në Udhëzimin Nr. 29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë"; në Rregulloren e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës; në Statutin e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës neni 15 "Funksionet e Senatit Akademik" pika 1, gërma "h"; në Urdhrin e Rektorit Nr. 429, datë 04.10.2024 për "Ngritjen e grupit të punës për hartimin e Rregullores për krijimin dhe funksionimin e grupeve mësimore, grupeve të përkohshme / të përhershme Kërkimore Shkencore, në UAMD", në mbledhjen e datës 18.12.2024, Senati Akademik,

V E N D O S I :

1. Miratimin e Rregullores për organizimin dhe funksionimin e grupeve mësimore dhe grupeve të përhershme ose të përkohshme kërkimore - shkencore pranë Njësive Bazë Të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Zv. Rektorët
 - Administratori
 - Drejtuesit e Njësive Kryesore
 - Drejtorët e Drejtorive
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” Durrës

RREGULLORE
PËR
ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E
GRUPEVE MËSIMORE DHE GRUPEVE TË PËRHERSHME OSE
TË PËRKOHSHME KËRKIMORE- SHKENCORE PRANË
NJËSIVE BAZË TË UNIVERSITETIT “ALEKSANDËR
MOISIU”DURRËS

Miratuar me Vendimin nr. 59, datë 18.12.2024 të Senatit Akademik

DURRËS

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Baza ligjore

Rregullorja “Për organizimin dhe funksionimin e grupeve mësimore dhe grupeve të përhershme ose të përkohshme me karakter kërkimor-shkencore në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës, mbështetet në Ligjin nr.80/ 2015 “Për Arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij; Kodin e Procedurave Administrative; Statutin dhe Rregulloren e Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës.

Neni 2

Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave, procedurave dhe mekanizmave për ngritjen, funksionimin, organizimin dhe drejtimin e grupeve mësimore dhe grupeve të përhershme ose të përkohshme kërkimore-shkencore brenda dhe midis njësive bazë të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës.

Neni 3

Fusha e zbatimit

Kjo rregullore e shtrin efektin mbi të gjitha grupet mësimore dhe grupet e përhershme ose të përkohshme kërkimore-shkencore që funksionojnë në nivel njësie bazë të UAMD-së, si dhe mbi të gjitha strukturat përgjegjëse për organizimin dhe funksionimin e tyre.

KREU II
NGRITJA DHE ORGANIZIMI I GRUPEVE
MËSIMORE DHE KËRKIMORE - SHKENCORE

Neni 4

Përkufizimi i grupeve

Grupet mësimore dhe grupet e përhershme ose të përkohshme me karakter kërkimor-shkencor janë struktura akademike në nivel të njësisë bazë që ndihmojnë në përmirësimin e cilësisë mësimore, zhvillimin e kërkimit shkencor dhe integrimin e tij në mësimdhënie, duke përfshirë personel akademik, personel ndihmës -akademik të fushave përkatëse. Ata mbulojnë veprimtarinë kërkimore-shkencore dhe mësimore të një ose më shumë disiplinave të ngjashme dhe të ndërruar të formimit të përgjithshëm dhe atij profesional.

Neni 5

Ngritja e grupeve

1. Njësia bazë mund të organizohet në grupe mësimore dhe grupe të përhershme ose të përkohshme me karakter kërkimor-shkencor, në përputhje me llojin dhe misionin e njësisë dhe me fushat kërkimore si dhe përmbajtjen e grup lëndëve kryesore. Si rregull, grupi mësimor zhvillon grup-lënde, e cila është një nënbashkësi e lëndëve të një programi studimi, që kanë një trung të përbashkët nga pikëpamja përmbajtësore dhe didaktike.
2. Grupi mësimor dhe ai kërkimor shkencor përbëhet nga jo më pak se 5 (pesë) anëtarë të punësuar me kohë të plotë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 1 (një) anëtar duhet të jetë me titull akademik.
3. Ngritja e një grupi me karakter mësimor dhe grupit të përhershëm ose të përkohshëm me karakter kërkimor- shkencor bëhet me propozim të jo më pak se 3 (tre) anëtarëve të asamblesë së personelit akademik të njësisë bazë përkatëse. Propozimi i përcillet përgjegjësit të njësisë bazë dhe duhet të përmbajë: arsyetim të argumentuar të nevojës për krijimin e grupit; ndikimin e krijimit të tij në strategjinë e zhvillimit të njësisë bazë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor, si dhe efektet financiare të krijimit të tij.
4. Drejtuesi i njësisë bazë brenda 30 (tridhjetë) ditëve mbledh asamblenë e njësisë bazë për shqyrtim të propozimit të paraqitur. Ndarja e grupeve si dhe lektorët përkatës bëhet duke iu referuar kryesisht profilit, vijueshmërisë së studimeve si dhe preferencës.
5. Vendimi i njësisë bazë për ngritjen e grupit ose grupeve i njoftohet Dekanatit, Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit të UAMD-së.

Neni 6

Kompetencat e grupeve mësimore dhe grupeve të përhershme ose të përkohshme kërkimore shkencore brenda njësisë bazë dhe midis tyre

1. Grupi është përgjegjës për grup-lëndët përkatëse që ofron në programet e studimit. Harton përmbajtjen e tyre dhe të programeve lëndore përkatëse, kjo në përputhje me kërkesat e kohës zhvillimit teknologjik dhe të ekonomisë në vend, për përditësimin në vazhdim të tyre, për mbulimin e tyre me personel të kualifikuar të brendshëm ose të jashtëm, si edhe të ftuar.
2. Grupi është përgjegjës për fushat mësimore dhe kërkimore-shkencore të tij dhe të secilit anëtar akademik në përbërje, kjo në përputhje me grup-lëndët mësimore.
3. Grupi është përgjegjës për saktësimin, zgjerimin dhe thellimin e fushave mësimore dhe kërkimore-shkencore, për kualifikimin e vazhdueshëm të personelit akademik në përbërje të tij, kryerjen e projekteve të përbashkëta kërkimore institucionale dhe ndërinstitutionale, pjesëmarrje në partneritete në projekte të veçanta që lidhen me fusha të përafërta apo plotësuese mësimore dhe kërkimore-shkencore, zgjerimin dhe thellimin e bashkëpunimit në funksion të ndërkombëtarizimit.
4. Dy ose më shumë njësi bazë brenda njësisë kryesore mund të vendosin të organizohen në grupe mësimore dhe kërkimore-shkencore me marrëveshje mes tyre.

Grupet mësimore dhe kërkimore – shkencore brenda njësisë bazë krijohen me vendim të kësaj të fundit, kurse midis njësive baze krijohen me vendim të dekanatit të njësisë kryesore, pasi të jenë propozuar nga njëra njesi baze dhe të jenë miratuar nga njësia baze të tjera bashkëpunuese.

Neni 7

Detyrat e Përgjegjës të Grupit mësimor dhe atij kërkimor- shkencor

1. Përgjegjësi i grupeve mësimore kryen këto detyra:

- a. Organizon punën për hartimin e programeve të lëndëve që i përkasin grupit mësimor për t'i propozuar më pas për miratim të drejtuesi i njësisë bazë;
- b. Ndjek respektimin e programeve të mësimdhënies në kohën e në mënyrën e caktuar.
- c. Ndjek aktivitetin shkencor të anëtarëve të grupit dhe për problemet që lindin informon të drejtuesi i njësisë bazë.
- d. Raporton tek drejtuesi i njësisë bazë për realizimin e programit mësimor në përfundim të çdo semestri, duke pasqyruar dhe mendimet e grupit mësimor.
- e. Organizon analizën vjetore të punës dhe depoziton në departament dokumentacionin e aktivitetit shkencor të secilit anëtar të grupit mësimor përkatës;
- f. Ndjek realizimin e ngarkesës mësimore të grupit;

- g. Mbështet dhe ndihmon përgjegjësin e njësisë bazë në mbledhjen e hartimin e dokumentacionit për akreditimin.
- h. Përgjegjësi grupit mësimor kryen çdo funksion tjetër të parashikuar nga aktet nënligjore dhe neni 29 i Rregullores së UAMD- së.

Përgjegjësi i grupit kërkimor- shkencor kryen këto detyra:

- a) Ndjek procesin e punës së grupit që drejton dhe i përcjellë raportin vjetor drejtuesit të njësisë bazë për realizimin e tij, duke pasqyruar dhe mendimin e grupit kërkimor-shkencor
- b) Drejton dhe ndjek veprimtarinë e anëtarëve të grupit dhe informon rregullisht njësinë bazë. Organizon analizën vjetore të kësaj pune në grup dhe depoziton në departament dokumentacionin e veprimtarisë shkencore të secilit anëtar.
- c) Përgatit informacion dhe ja përcjell atë anëtarëve të grupit si dhe drejtuesit të njësisë bazë mbi :
 - problematika lidhur me punën e grupit të drejtuar nga ai;
 - bashkëpunime ndërinstytucionale dhe projekte ku merr pjesë grupi, ku paraqiten të dhëna mbi institucionin bashkëpunues apo projektin; mbi kontratën, datën dhe formën e zyrtarizimit të bashkëpunimit apo të projektit; fusha e bashkëpunimit; detyrat e palëve dhe produktet, rezultatet apo përfitimet që priten nga ky bashkëpunim;
 - mbi projekte ku merr pjesë si palë aktive dhe bashkëpunuese;
 - të dhëna mbi lidhjet e kërkimit shkencor në kuadër të programeve të studimit me komponentë të rëndësishëm kërkimor;
 - produktet në fushën e kërkimit shkencor të paraqitura në formën e botimeve shkencore, artikujve, projekteve të fituara dhe të realizuara, pjesëmarrjes në veprimtari brenda dhe jashtë vendit, veprimtari shkencore të organizuara nga njësi.
- d) Nxiti dhe mbështet nismat shkencore individuale dhe kolektive të anëtarëve të tij, por edhe të studentëve ekselentë për ta bërë më efikase veprimtarinë kërkimore-shkencore.
- e) Planifikon financimin e projekteve kërkimore-shkencore dhe e paraqet atë për miratim në autoritetet dhe organet drejtuese vendim-marrëse të UAMD-së.
- f) Mbështet dhe ndihmon përgjegjësin e njësisë bazë në mbledhjen e hartimin e dokumentacionit për akreditimin.
- i. Përgjegjësi i grupit kërkimor kryen çdo funksion tjetër të parashikuar nga aktet nënligjore dhe neni 29 i rregullores së UAMD- së.

Neni 8

Zgjedhja e Përgjegjësit të Grupit mësimor dhe atij kërkimor- shkencor

1. Përgjegjësi i grupit mësimor dhe i grupeve të përhershme ose të përkohshme kërkimore shkencore është personel akademik me kohë të plotë, i kategorisë “Profesor”. Kandidatura për përgjegjësin e grupit vetëkandidohet nga radhët e grupit mësimor dhe grupit të përhershëm ose të përkohshëm kërkimor-shkencor ku ai bën pjesë dhe zgjidhet me votim të hapur nga personeli akademik i grupit ku ai/ajo kandidon, sipas kriterëve të përcaktuara nga Senati Akademik. Në mungesë të kandidaturave me titull “Profesor”, kategoria për përzgjedhjen e përgjegjësit mund të zbresë në kategorinë “Doktor”, për një afat jo më të gjatë se 1 vjeçar.
2. Pas përfundimit të procesit të zgjedhjes, drejtuesi i njësisë bazë i përcjell për emërim drejtuesit të njësisë kryesore kandidaturën fituese.
3. Përgjegjësi i grupit mësimor dhe kërkimor shkencor, me karakter të përhershëm emërohet nga drejtuesi i njësisë kryesore për një afat 4 vjeçar, ndërsa afati i përgjegjësit të grupeve kërkimore-shkencore të përkohshme, përfundon me përfundimin e afatit të përcaktuar në vendimin për miratimin e grupit të përkohshëm.

Neni 9

Largimi nga detyra i Përgjegjësit të Grupit

1. Përgjegjësi i grupit përkatës largohet nga detyra në rastin e shkeljeve të rënda ose të përsëritura, ose kur nuk zbaton detyrat e përcaktuara në rregullore:
 - me propozim të drejtuesit të njësisë bazë;
 - me propozim të anëtarëve të grupit që ai drejton.
2. Vendimi i njësisë bazë për shkarkimin e përgjegjësit të grupit, merret me votim të hapur dhe i njoftohet Dekanatit, Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit të UAMD-së.

Neni 10

Planifikimi i veprimtarisë dhe ngarkesës mësimore të personelit akademik në njësinë bazë

1. Jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë përpara fillimit të vitit të ri akademik, titullari/ bashkëtitullarët e lëndës, të cilët janë personel akademik të kategorisë “Profesor”, rishikojnë *syllabus-in* e lëndës në përputhje me VKM- në perkatëse, që përcakton elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë. Në rast se, njësia bazë është e organizuar në grupe mësimore dhe kërkimore-shkencore, *syllabus-i* i lëndës dorëzohet te Përgjegjësi i grupit mësimor dhe

- kërkimor shkencor, i cili jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara fillimit të vitit të ri akademik, i përcjell për miratim te drejtuesi i njësisë bazë.
2. Jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë përpara fillimit të vitit akademik, titullari dhe bashkëtitullarët e lëndës, në koordinim dhe bashkëpunim me secilin prej personelit akademik të lëndës dhe në rast se, njësia bazë është e organizuar në grupe mësimore dhe kërkimore shkencore, i përcjellin fillimisht përgjegjësit të grupit, propozimin për planifikimin dhe shpërndarjen e ngarkesës dhe mbingarkesës mësimore të lëndës dhe lëndëve, i cili, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara fillimit të vitit të ri akademik i përcjell tek drejtuesi i njësisë bazë.
 3. Jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë përpara fillimit të vitit akademik, drejtuesi i njësisë bazë, pasi mbledh informacionin mbi angazhimin e personelit akademik në lëndët përkatëse mbi bazën e planifikimit të ngarkesës dhe mbingarkesës mësimore të kryer prej titullarit të lëndës, apo prej përgjegjësit të grupit mësimor dhe kërkimor shkencor, vijon me thirrjen e mbledhjes së njësisë bazë për miratimin e planifikimit dhe shpërndarjes së ngarkesës mësimore, e cila miratohet me vendim të saj, e dokumentuar me procesverbalin përkatës.
 4. Në ato njësi bazë, që kanë në përbërje të tyre grupe mësimore dhe kërkimore-shkencore, shpërndarja e ngarkesës mësimore propozohet paraprakisht me vendim të grupit mësimor dhe kërkimor shkencor dhe me vendim përfundimtar të njësisë bazë, e dokumentuar me procesverbalin përkatës.
 5. Nëse ka mosmarrëveshje ndërmjet personelit akademik të një lënde për planifikimin dhe shpërndarjen e ngarkesës dhe mbingarkesës mësimore, fillimisht drejtuesi i njësisë bazë, në respektim të dispozitave të Statutit dhe Rregullores së UAMD-së, në një mbledhje të njësisë, bashkërendon këtë shpërndarje ndërmjet tyre dhe zgjidh mosmarrëveshjet në mënyrë të drejtë, duke respektuar interesat dhe atributet e personelit akademik dhe nevojat e njësisë.
 6. Shpërndarja e ngarkesës mësimore për orët në auditor dhe udhëheqjet e diplomave të ciklit I dhe II, midis anëtarëve të grupit mësimor dhe kërkimor shkencor bëhet duke mbajtur në konsideratë:
 - kualifikimin akademik të anëtarit personeli akademik me kohë të plotë të njësisë bazë;
 - numrin e personelit akademik me kohë të plotë për secilin grup;
 - zbatimin e udhëzimeve dhe ruajtjen e proporcionalitetit në raport me ngarkesën mësimore totale, që duhet të përballojë grupi mësimor dhe kërkimor shkencor.
 7. Plotësimi i evidencave të realizimit të ngarkesës mësimore të anëtarëve të grupit, fillimisht verifikohet nga titullari dhe bashkëtitullarët i/e lëndës, i/të cili/cilët kontrollon/jnë kryerjen e tyre nga çdo pedagog i lëndës, në përputhje me planifikimin e shpërndarjes së ngarkesës mësimore. Më pas, plotësimi i evidencave, verifikohet nga përgjegjësi i grupit mësimor dhe kërkimor shkencor dhe njësisë bazë, në raport me planifikimin e shpërndarjes së ngarkesës mësimore në fillim të vitit akademik dhe miratohet nga drejtuesi i njësisë bazë.

KREU III

FINANCIMI DHE INFRASTRUKTURA

Neni 11

Burimi i financimit

Grupet financohen nga buxheti i universitetit, fondet e miratuara nga njësia kryesore, projektet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Neni 12

Infrastruktura

1. Në funksion të realizimit të detyrave dhe kompetencave të grupeve, ata kanë të drejtë të përdorin infrastrukturën mësimore dhe kërkimore të UAMD-së, përfshirë auditoret, zyrat, laboratorët, bibliotekat, pajisjet teknologjike, si dhe çdo mjet i cili është në pronësi të UAMD-së dhe mund të shërbejë për përmbushjen e detyrave të grupeve dhe sipas kësaj rregulloreje.
2. Përgjegjësi i grupit, në mënyrë të argumentuar, mund të kërkojë mbështetje me personel ndihmës akademik me karakter akademik dhe personel ndihmës akademik me karakter administrativ nga njësia kryesore ose ajo bazë, për realizimin e projekteve të veçanta mësimore dhe kërkimore.

KREU IV

VLERESIMI DHE MONITORIMI

Neni 13

Vlerësimi i performancës së grupeve

1. Njësia bazë dhe ajo kryesore, vlerëson veprimtarinë e grupeve mësimore dhe atyre kërkimore-shkencore, jo vetëm për të matur performancën dhe përparimin e anëtarëve të grupeve në karrierën akademike, por edhe mbi bazën e publikimeve shkencore, pjesëmarrjes në konferenca, projekte institucionale, nderinstitucionale si dhe efikasitetin e fondeve të përdorura në funksion të përmirësimit të politikave mësimore dhe ato kërkimore-shkencore.

2. Grupi parashikon në politikat e tij ruajtjen e të dhënave dhe rezultateve të veprimtarisë kërkimore- shkencore, si edhe të drejtën e konsultimit të tyre nga anëtarët e tjerë personel akademik, studentët, si dhe studiuesit e interesuar.

Neni 14

Monitorimi nga Rektorati

Rektorati monitoron tërësinë e grupeve për të siguruar permbushjen e objektivave mesimore dhe kërkimore shkencore, jep udhëzime, rekomandime, bashkërendon dhe ndihmon në bashkëpunimin ndërkombëtar.

KREU V

DISPOZITA TE TJERA

Neni 15

Zgjidhja e konflikteve

Mosmarrëveshjet mes përgjegjësit të grupit, anëtarëve të tij dhe drejtuesit të njësisë bazë, zgjidhen nga drejtuesi i njësisë kryesore përkatëse.

Neni 16

Mbyllja e grupeve

Grupet që nuk përmbushin objektivat e paraqitura në propozimin për krijimin e grupit për dy vite radhazi mund të mbyllen me vendim të njësisë bazë përkatëse. Grupet e krijuara midis departamenteve mbyllen me vendim të dekanatit të njësisë kryesore.

KREU VI

DISPOZITA KALIMTARE DHE TE FUNDIT

Neni 17

Hyrja në fuqi

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit të saj nga Senati Akademik.
2. Ndryshimi i kësaj Rregulloreje bëhet sipas parashikimeve në Statutin dhe Rregulloren e UAMD-së.
3. Miratuar me Vendim të Senatit Akademik nr. 59 dt. 18/12/2024